

11.6 FSHIRJA E REGJISTRIMIT TË RUAJTUR PËRKOHËSISHT

Pasi regjistrimi është ruajtur në bazën përkatëse bibliografike ose të njësuar të të dhënave, regjistrimi i ruajtur në skedarin e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht duhet të fshihet.

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**.
Hapet dritarja **Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**, ku në pjesën e sipërme ndodhet lista e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht (shih figurën 11.3-1).
2. Përzgjidhni regjistrimin nga lista dhe klikoni butonin **Fshi**.
Programi kërkon konfirmimin për fshirje.
3. Klikoni butonin **Po**.
Regjistrimi fshihet nga skedari i regjistrimeve të ruajtura përkohësisht.